



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA VAU-DEJES

Qyteti Vau-dejes, tel. 026622751

Nr _____ Prot

Dt _____ / _____ 2014

**K O N T R A T E S I P E R M A R R J E
P U N E P U B L I K E**

**“Rikonstruksion i shkolles 9-vjeçare Aleksander Paloci,Shelqet,Bashkia Vau
Dejes(shkolle e djegur) Shkoder”**

E lidhur sot me datë date 19.09.2014 midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Vau-Dejes e përfaqësuar nga Kryetari i saj Z. Gjon Marku
Dhe

Operatorit Ekonomik”Firma”NIKA”sh.p.k.., perfaqesuar nga administrator Shpresa Nika me tagër dhe kompetencë të plotë për të vepruar dhe përfaqësuar shoqërinë në të gjitha marrdhënjet me investitorin Bashkia Vau-dejes për realizimin e objektit të kontratës.

**Neni 1
BAZA LIGJORE**


- a. Kodi Civil ligji nr.7850,date29.07.1994 me ndryshimet perkatese,pjesa V-te,”KONTRATAT”titulli I-re(kreu I-re deri tek kreu III-te),titulli II-te(kreu VII-te), nenet 850 e vijim.
- b. Ligji Nr.9643 date 20.11.2006 “Per Prokurimin Publik” i ndryshuar.
- c. VKM nr.1 dt.10.01.2007 “Per Miratimin e rregullave te prokurimit publik” i ndryshuar.
- d. VKM Nr. 659, date 03.10.2007 “Per prokurimin publik me mjete elektronike”
- e. Ligji nr.8402 ,date 10.09.1998 “Per Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve te ndertimit
- f. i ndryshuar me ligjin nr.9794,dt.23.07.2007.
- g. Udhezimi i K.M nr.2 ,date 13.05.2005 “Per zbatimin e punimeve te ndertimit”
- h. Urdher prokurimi nr.17,dt.12.08.2014,i kryetarit te autoritetit kontraktore Z.Gjon Marku,
- i. Vendimi nr 05,dt.05.09.2014,i kryetarit te autoritetit kontraktor z.Gjon Marku,per miratim te klasifikimit perfundimtar..

**Neni 2
OBJEKTI I KONTRATES**

Objekt i kësaj kontrate është ”Rikonstruksion i Shkolles 9 vjeçare”Aleksander

Neni 3

NIKA
SH.P.K.
SHKODER
ALBANIA



VLEFTA E KONTRATES

Kontrata lidhet për vleren 3.041.265 leke (pa Tvsh) dhe vlera totale e kontrates është 3.649.518 leke me t.v.sh.. Kjo shume do të likujdohet nga fondet e akorduara nga buxheti i shtetit (Ministria e Arsimit) Fondi për zhvillimin e rajoneve. Vlera totale e kontrates me prej 3.649.518 leke me t.v.sh, do të kalojë operatorit ekonomik në dy faza. Per vitin 2014, 2.840.169 leke me t.v.sh. Per vitin 2015 809.349 leke me t.v.sh. kjo shume do të kalojë operatorit ekonomik pranë Bankes Rajfajzen Shkoder në llogarinë nr. llogarise 1400001145, NIPT J76705047U

Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës shtese nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori sipas preventivit bashkelidhur kesaj kontrate.

Neni 4 AFATI I KONTRATES

Kontrata shtese do të realizohet brenda 60 dite kalendarike, duke filluar ky afat nga momenti i nënshkrimit të kontrates.

Neni 5 GJUHA E KONTRATES

Gjuha e kontrates është gjuha shqipe.

Neni 6 PËRKUFIZIME

- a. *Formulari i ofertes* është dokumenti i plotësuar që sipërmarrësi ka dorëzuar në datën e zhvillimit të garës dhe është pranuar nga Investitori.
- b. *Vlera e kontrates* është vlera e dhene në njoftimin e fituesit që autoriteti kontraktor i ka dërguar operatori ekonomik fitues mbi bazën e të cilës është plotësuar e dorëzuar formulari i kontratës, nga ky i fundit.
- c. *Dita e perfundimit* është data e vertetuar nga autoriteti kontraktor.
- d. *Operatori ekonomik* është një person juridik i pranuar nga investitori.
- e. *Ditët* janë dite kalendarike, muajt janë muaj kalendarike.
- f. *Data e fillimit* është data pas lidhjes së kontrates, me marrjen e lejes së ndertimit dhe të lirimimit të sheshit të ndertimit.
- g. *Ndryshimi* është një udhëzim që jep autoriteti kontraktor i parashikuar në dokumentat fillestare dhe jepet gjithmonë me shkrim.
- h. *Preventiv* për njësi * janë vëllimet e punës të plotësuar me çmime, pjesë përbërëse e ofertes.

NIPT J76705047U
SHKODER




- i. Raste të kompensuara janë ndërrimet paraqitura në kontratën.
- j. **Defekt** është çdo pjesë e punimeve të papërfunduar në përputhje me kontratën.
- k. **Periudha e garancisë** për defektet e punimeve është 24 muaj pas datës së aktit të kolaudimit.
- l. **Skicat (vizatimet)** përfshijnë projekte dhe të dhëna të tjera të paraqitura ose të miratuara nga autoriteti kontraktor për mbushjen e kontratës.
- m. **Autoriteti kontraktor** është organi që vë në dispozicion fondin.
- n. **Drejtuesi i Projektit** (mbikqyresi i punimeve-supervizori) është personi i emruar nga Autoriteti kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për autoritetin kontraktor.
- o. **Inxhinieri zbatues** është personi i aprovuar nga Autoriteti Kontraktor, përfaqësues i operatorit ekonomik, përgjegjës për kryerjen dhe përfundimin e punimeve, për të cilin sipërmarrësi është i detyruar t'i konfirmojë Autoritetit Kontraktor emrin e tij.
- p. **Pajisjet** janë makineritë e operatorit ekonomik të sjella përkohësisht në kantierin ku do të kryhen punimet.
- q. **Materialet, prodhime të gatshme dhe gjysem të gatshme** janë furnizimet që përfshijnë edhe ato të konsumit të përdorur nga operatori ekonomik për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me standartet në R.SH.
- r. **Specifikimet** janë karakteristikat e punimeve të përfshira në projektet e zbatimit dhe në kontratë dhe çdo modifikim ose shtesë e bërë dhe e miratuar me shkrim nga autoriteti kontraktor, projektuesi dhe drejtuesi i projektit.
- s. **Punimet ndërtimi** janë ato punime që duhet të kryhen nga operatori ekonomik në përputhje me kontratën dhe t'ia dorëzojë autoriteti kontraktor me përfundimin e tyre.
- t. **Situacioni**: quhet dokumenti i evidentimit faktik të situatës së punës së kryer në përputhje me zërat e punimeve të përcaktuar në kontratë (volumet), në përputhje me procesverbalet ditore. Situacionet janë ditore, mujore dhe vjetore.
- u. **Proces-verbal**: quhet dokumenti i hartuar nga përfaqësuesit e Bashkisë Vau-Dejes mbi kontrollin e ushtruar në terren që reflekton punën e pakryer, gjomat dhe penalitetet e vendosura në përputhje me kushtet e kësaj kontrate, cilësinë e mirëmbajtjes së sipërfaqeve të gjelbërta dhe problemet e konstatuara gjatë kontrollit.


Neni 7 KOMUNIKIMI

Komunikimi ndërmjet palëve duhet të bëhet vetëm me shkrim. Njoftimi bëhet efektiv vetëm pasi të dorëzohet.

Neni 8 PERSONELI

- a. Operatori Ekonomik duhet të punësojë vetëm personelin (stafin) e deklaruar në ofertë për kryerjen e funksioneve të parashikuara në programin e miratuar nga drejtoria e projektit.
- b. Drejtuesit ligjorë dhe teknik të operatorit ekonomik janë përgjegjës përpara autoritetit kontraktor për ndërtimin e vepres, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë sipas dispozitave ligjore në fuqi.
- c. Drejtuesi teknik i punimeve sigurohet drejtperdrejtë nga drejtuesi teknik i operatorit ekonomik ose përgjegjësi teknik i kantierit.


N. NIKOLAJ SH.P.R.
NR. 1/2019/138479
PRANISHT - ALBANIA



- d. Drejtuesi teknik i kantierit eshte rezident ne kohe pune te plote ne objekt dhe i diplomuar ne inj.ndertimi.
- e. Drejtuesi i Projektit do te miratoje çdo propozim te operatori ekonomik për të zëvendësuar personelin kryesor vetëm n.q.s. kualifikimet dhe aftësitë e tyre të nevojshme janë të barabarta ose më të larta se ato të personelit të percaktuara ne oferte.
- f. *N.q.s. Drejtuesi i Projektit i kërkon operatori ekonomik që të largojë një person, i cili është anëtar i personelit ose i fuqise punëtore të operatorit ekonomik, duke theksuar arsyet, operatori ekonomik do të marrë masa për të siguruar që personi në fjalë të largohet nga kantieri i punimeve brenda 72 orëve dhe të mos ketë më lidhje me punën e përfshirë në kontratë.

Neni 9 PREVENTIVI

Preventivi do të përfshijë të gjithë zërat e punimeve "Rikonstruksion i shkolles 9 vjeçare Aleksander Paloci,Shelqet,Bashkia Vau dejes(shkolla e djegur).

. Ai do të përdoret për të llogaritur vlerën e situacioneve pjesore progresive dhe ne teresi vleren perfundimtare te kontratës. Operatori ekonomik paguhet me sasinë e punës së kryer sipas projektit, bazuar për çdo zë pune të preventivit.


Neni 10 NDRYSHIME TË URDHERUARA

- a. Operatori ekonomik nuk mund te ndryshoje me nismen e vet , te subjektit projektues a mbikqyres ,projektin dhe pershkrimet teknike te tij.
- b. Çdo ndryshim i udhëruar nga autoriteti kontraktor i cili ne asnje rast te mos sjellë rritjen e vlerës së kontratës, do të jetë detyrimisht objekti i një proces verbali me shkrim i firmosur nga autoriteti kontraktor. Këto urdhëra do të hartohen në bazë të një propozimi teknik nga ana e autoritetit kontraktor dhe në bazë të llogarisë përkatëse të bërë nga operatori ekonomik dhe te miratuara nga drejtuesi i projektit e projektuesi mbështetur në çmimin per njësi për çdo zë pune shprehur në preventivin e ofertes fituese.
- c. Operatori ekonomik eshte i detyruar te zbatoje çdo ndryshim te urdheruar me shkrim nga autoriteti kontraktor ose persona te autorizuar prej tij, qe nuk ndryshon, ne thelb, kushtet kryesore te projektit, te kontrates dhe nuk rrit vleften e saj.
- d. Propozimet per rritjen e vleftes se kontrates dhe zgjatjen e afatit te punimeve i paraqiten autoriteti kontraktor, nepermjet mbikqyresit te punimeve, kur ato permisojne treguesit e vepres, vijne nga shkaqe pamundesisht te paparashikueshme, ne kohen e duhur dhe nuk jane ne kundërshtim me kushtet e kontrates.
- e. Ndryshimet e miratuara nga autoriteti kontraktor sipas pikave qe permendem me lart, se bashku me dokumentacionin e nevojshem teknik, ekonomik e administrativ, i dorezohen zyrtarisht operatori ekonomik.

Neni 11 RREZIQET E OPERATORIT EKONOMIK

Nga data e fillimit e deri në fund të periudhës së përfundimit të punimeve (deri në datën e lëshimit të certifikatës se korigjimit të defekteve) për defektet që jepen në të dhënat e kontratës.

MIRA SH. R. A.
NIPIT 336705000
SHRUBEN - BASHKIA



operatori ekonomik do të përballojë rreziqet për shkak të dëmtimeve personale, vdekjes dhe humbjes ose dëmtimit të pasurisë (përfshirë pa kufizime punimet, materialet dhe pajisjet).


Neni 12 SIGURIMET

1. Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes në kantier deri në Afatin e Realizimit së Plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të Punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.
2. Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anuluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbrisi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.
3. Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

Neni 13 OPERATORI EKONOMIK QË DO TË KRYEJE PUNIMET

- a. Operatori ekonomik do të kryej punimet në përputhje me projektet e dhëna nga autoriteti kontraktor, dhe në përputhje me specifikimet teknike.
- b. Operatori ekonomik i punimeve të ndertimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndertimit të kontraktimit. **Permbajtja e kontratës nuk është mjet për të shmangur zbatimin standarteve dhe të rregullave teknike në fuqi.**
- c. Operatori ekonomik ruan dhe nuk lejon përdorimin a kalimin e pronësive të dokumentave, që i ve në dispozicion autoriteti kontraktor, të personat e paautorizuar.
- d. Operatori ekonomik gjatë gjithë kohës së zbatimit të kontratës paraqet kërkesë-propozimet për korrigjime, plotësime apo permisime në projekt dhe për mungesat e pasaktësitë, ligjore a kontraktuale të dokumentacionit të dorëzuar.
- e. Operatori ekonomik, me kërkesë të mbikqyresit, programon kryerjen e punimeve, për çdo muaj, dhe korrigjon e permision elemente të projekt organizimit për mos realizimin e kushteve thelbësore të kontratës.
- f. Projekt organizimi i punimeve përmban planin e ngritjes dhe të organizimit të kantierit, grafikun e përgjithshëm të punimeve dhe planin e veprimt, për ndertimin e objektit, sipas projektit, në përputhje me afatet dhe kushtet e kontratës.
- g. Operatori ekonomik kryen punime të veçanta, të parashikuara në kontratë me nën sipërmarrje, vetëm me miratim paraprak të autoritetit kontraktor. Marrëdhëniet dhe kushtet e nën sipërmarrjes rregullohen me marrëveshje dypalëshe, e cila në asnjë rast nuk duhet të bëjë në kundërshtim me detyrimet kontraktore të operatorit ekonomik. Operatori ekonomik i punimeve

1
N. N. N. S.H.P. K
N. N. N. 149735173
SHKODER - ALBANIA



eshte, ne cdo rast,pergjegjes ndaj autoriteti kontraktor per punimet e nensipermarrjes dhe dokumentacionin teknik,ekonomik e administrativ.

h. Nesipermarresi i punimeve te vecanta te ndertimit duhet te plotesoje kushtet e nje subjekti te mirefillte per zbatim punimesh.

i. Kur autoriteti kontraktor bindet qe operatori ekonomik shkel kushtet e kontrates,lajmeron,me shkrim,operatorin ekonomik per zgjidhjen e marreveshjes dhe largimin me shkrim te nensipermarresit.

j. Inxhnieri zbatues i operatorit ekonomik në kantier është i detyruar të mbajë ditarin e objektit, ku të përfshihen të gjitha punimet e kryera në urdhrat e dhëna për zbatimin e projektit. Ky ditar në çdo kohë do t'i vihet në dispozicion drejtuesit te projektit, grupit të kolaudimit ,autoriteti kontraktor dhe organeve te ligjeruara per kontroll.

k. Operatori ekonomik jo me pak se 10 dite perpara fillimit te punimeve,njofton me shkrim seksionin e urbanistikes,qe ka leshuar lejen,dhe degen rajonale te Policise se Ndertimit.Ne njoftim jepen te dhena per objektin, autoritetin kontraktor/operatorin ekonomik,subjektin projektues e mbikqyres,dokumentacionin administrativo-ligjor te miratuar dhe per personelin drejtues te kantierit te punimeve.

l. Seksioni i urbanistikes njoftohet,zyrtarisht,nga operatori ekonomik per kontrollin e punimeve menjehere me piketimin e objektit,me perfundimin e punimeve ne kuoten +/-0,00 dhe ne perfundimin e karabinase.

Neni 14 PROGRAMI

Brenda 5 diteve nga nënshkrimi i kontratës shtese operatori ekonomik do t'i paraqese per miratim drejtorit të projektit një program, në të cilin tregohet mënyra e kryerjes së punimeve, grafiku kohor. Operatori ekonomik do të realizojë programin sipas grafikut të parashikuar per afatin kohor te percaktuar ne kete kontrate.

Neni 15 SPECIFIKIMET TEKNIKE

Kontrata bazohet ne specifikimet teknike te hartuara nga autoriteti kontraktor (Njesia e prokurimeve) dhe qe pranohen shprehimisht nga palet ne kontrate. Specifikimet teknike janë pjesë përbërëse aneks i kësaj kontrate baze.

Neni 16 SIGURIMI TEKNIK


a. Operatori ekonomik është përgjegjësi për të gjitha veprimtaritë në kantierin e ndërtimit, duke zbatuar masat korigjuese teknike për të gjithë personelin.

b. Operatori ekonomik eshte pergjegjes per kontrollin dhe respektimin e kerkesave te kontrates per cilesine e punimeve.Ai eshte i detyruar te kryeje te gjitha provat dhe inspektimet ne punimet e ndryshme te ndertimit, te detyrueshme nga kushtet teknike ne fuqi.

c. Operatori ekonomik detyrohet te siguroje ne kantier:

1. punemarres te afte,tekontrolluar per shendetin,me leje per ushtrim profesionesh te vecanta (deshmi,leje,autorizime),nga organet e autorizuara me ligj.
2. materiale,pajisje,mjete mbrojtese,kolektive e individuale dhe tabela paralajmeruese.

RIPI JET
SHRODET
SHRODET



3. mirembajtjen dhe kontrollin periodik te makinerive e te mekanizmave te istaluar ne objekt,per pune pa rrezik.
4. rregullore,urdhra e udhezime ne fuqi,per sigurimin teknik dhe mbrojtjen ne pune.
5. librin e instruktimit per sigurimin teknik dhe mbrojtjen ne pune te punemarresve.

Neni 17 KORIGJIMI I DEFEKTEVE

- a. Drejtuesi i Projektit do të njoftojë operatorin ekonomik lidhur me çdo defekt para mbarimit të periudhës së garancisë për defektet. Periudha e garancise për defektet do të shlyhet deri sa të korigjohen defektet.
- b. Çdo herë që njoftohet nje defekt, operatori ekonomik do të korigjoste defektin brenda afatit të parashikuar nga njoftimi i drejtuesit te projektit.

Neni 18 DEFEKTET E PAKORIGJUARA

N.q.s. operatori ekonomik nuk e korigjon defektin brenda afatit të percaktuar në njoftimin e drejtuesit te projektit, ky i fundit do të vlerësojë koston e korigjimit të defektit dhe operatori ekonomik duhet të paguaj këtë shumë . autoriteti kontraktor do t'i mbajë këtë shumë operatorit ekonomik duke ia zbritur nga pagesa pasardhëse.

Neni 19 SITUACIONET

- a. Operatori ekonomik do t'i paraqese drejtuesit te projektit situacionet pjesore dhe progresive për punimet e kryera, duke zbritur finacimet e mëparshme, duke perfshire ne progresiv vleren e paradhenies ,vleren e garancise se cilesise se punimeve ,vleren e defekteve te pakorrigjuara etj, sikurse përcaktohet në këtë kontratë.
- b. Drejtuesi i projektit do të kontrollojë punën e kryer nga operatori ekonomik dhe do të vërtetojë shumën që do t'i paguhet operatori ekonomik brenda 30 ditëve nga data e paraqitjes se situacionit nga Operatori ekonomik. Vlera e punimeve të kryera do të përcaktohet nga drejtuesi i projektit dhe do të përfshijë vlerën e volumeve të zërave të punimeve të përfunduara dhe shprehura në situacion .
- c. Vlera e punës së kryer do të përfshijë vlerat e ndryshimeve dhe rastet e kompensuara.


Neni 20 PAGESAT

- a. Pagesat per çdo situacion punimesh do të kryhen nga autoriteti kontraktor brenda 30 ditëve nga dita e firmosjes së situacionit nga drejtuesi i projektit.
- b. Zërat e punimeve për të cilat nuk është vënë çmim për njësi në ofertën e paraqitur, nuk do të paguhen dhe do të konsiderohen si të mbuluara nga vlerat e tjera të përfshira në kontratë.

Neni 21 PARADHËNIA

- a. Autoriteti kontraktor mund ti paguaj operatorit ekonomik një paradhënie pagesa paraprake nuk ka..

SH.P.R
17/05/2010
SHKURT - ALBANIA



b. Paradhënia zbritet sipas perqindjes se dhene ne situacionet progresive që paraqet operatori ekonomik .Ajo duhet te likuidohet plotesisht brenda afatit kohor te kontrates.

Neni 22 RASTE TË KOMPENSUARA

***Raste të kompensuara për të cilat vonesa justifikohet do të konsiderohen si vijon.**

- a. Drejtoria e punimeve urdhëron shtyrjen ose nuk jep skicat (vizatimet specifikimet ose udhëzimet e nevojshme për kryerjen e punimeve në kohën e caktuar.
- b. Drejtoria e punimeve udhëzon operatorin ekonomik për të zbuluar punimet e fshehta ose për të kryer provat para kryerjes se punimeve.
- c. Autoritetet publike ose autoriteti kontraktor shkaktojnë vonesa ose shpenzime shtesë për operatorin ekonomik.
- d. Vonesa e pagesave të radhës për çdo vërtetim punimesh.
- e. Autoriteti kontraktor vonon pa arsye lëshimin e çertifikatës së marrjes në dorëzim.

f. *Kompensimi i Rasteve të sipërpmdura do të bëhet si vijon.

- g. Për vonesat e përmendura në tre pikat e para të paragrafit të mësipërm.
- h. Autoriteti kontraktor do të njoftojë shlyerjje e datës mbi atë të parashikuar në këtë kontratë.
- i. Për dy pikat e fundit në veçanti do të njohë edhe shpenzimet eventuale.
- j.

Neni 23 TAKSAT

- a. Operatori ekonomik është i detyruar të paguaje të gjitha taksat ne përputhje me legjislacionin shqiptar.
- b. Për taksat e përcaktuar në legjislacionin që kanë hyrë në fuqi deri në ditën e nënshkrimit të kontratës, të cilat operatori ekonomik duhet t'i kishte marrë parasysh në vlerën e kontratës, autoriteti kontraktor nuk duhet të njohë asnjë shtesë pagese.
- c.

Neni 24 NDALESAT, PENALITETET DHE GJOBAT

- a. Operatori ekonomik do ta zhdëmtojë Bashkinë për çdo dëmtim të shkaktuar për shkak të tij.
- b. Operatori ekonomik i nënshtrohet ndalesave dhe penalitetetve për punë të pakryer si më poshtë:
 - 1. Në raste kur identifikohen zëra të punës së pakryer, të parshikuar nga preventivi i kontratës nga Bashkia, atëherë përveç ndalesës për punë të pakryer, Operatori ekonomik do të penalizohet me 5-fishin e vlerës së zërit përkatës.
 - 2. Në rastin kur Operatori ekonomik nuk kryen me cilësinë e kërkuar nga specifikimet teknike të kontratës shërbimin e proceseve të parashikuara për

NIKA SH...
NIPT 1781...
SHKUDER...
KALANIA



penalizonet me zbatim e vleres se zeri perkates.

3. Sipërmarrësi është i detyruar që të mos angazhojë punëtorë të tjerë jo të shoqërisë. Punonjësit e tij operatori ekonomik detyrohet ti pajisë me u uniforma, në të cilat të jenë vendosur qartë shenjat dalluese të shoqërisë sipërmarrëse (operatori ekonomik). Në rastin e mosrespektimit të një detyrimi të tillë Supervizori i bën njoftim për respektimin e detyrimit. Nëse operatori ekonomik nuk merr masa Brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, Supervizori aplikon gjobë në masën 50.000 deri 200.000 lekë.

Neni 25

DËMSHPËRBLIMI PËR VONESAT

Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifen ditore 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por jo më pak se 25% të vlerës së saj.

Neni 26

GARANCIA

*5% e përcaktuar në të dhënat e kontratës do t'i mbahet operatorit ekonomik në situacionet pjesore progresive dhe atë perfundimtar si garanci për cilësinë e punimeve. Këto para do t'i paguhet operatorit ekonomik pasi të ketë përfunduar periudha e garancisë për defektet, periudhë kjo 24 muaj nga akt kolaudimi perfundimtarë

*Sigurimi i kontrates në masën 10 % të preventivit të miratuar, ofertes fituese.

Do të merret parasysh neni 866 i Kodit Civil i Republikës së Shqipërisë.

Neni 27

KOSTOJA E RIPARIMEVE

Dëmtimi i punimeve ose humbja e materialeve që do të përdoren për punime nga dita e fillimit deri në marrjen në dorëzim të punimeve do të mbulohet nga operatori ekonomik me shpenzimet e tij n.q.s. dëmtimi ose humbja janë shkaktuar nga gabimet e veprimeve të tij.

*Riparimet që dalin të nevojshme gjatë kolaudimit të veprës nëse janë shkak të mos plotësimit të kontratës ose të punës jo cilësore të operatorit ekonomik do të mbulohen nga ky i fundit me shpenzimet e tij.


*Operatori ekonomik nuk do të jetë përgjegjës për likuidimin e dëmeve të shkaktuara nga forcat madhore si tërmetet, përmbytjet ose gjendja e jashtëzakonshme që mund të ndodhë gjatë zbatimit të punimeve, të cilat janë jashtë kontrollit të operatorit ekonomik dhe që nuk konsiderohen si neglizhencë e tij.

Neni 28

MARRJA NE DORËZIM E PUNIMEVE

Operatori ekonomik pas përfundimit të punimeve i paraqet drejtuesit të projektit dokumentacionin dhe llogaritjet përfundimtare për punimet e kryera të cilat drejtuesi i projektit mbasi bën verifikimin nga ana e tij ia paraqet autoritetit kontraktor. Autoriteti kontraktor në rast se gjatë kolaudimit të veprës konstaton defekte që janë pasojë e punës jo cilësore të operatorit

[Signature]
KONTRAKTORI
MARRJA NE DORËZIM
E PUNIMEVE



ekonomik do t'i paraqese verejtjet me shkrim dhe do të kërkojë riparimin e tyre brenda 5 ditëve.
Pas riparimit të defekteve nëse ka korigjime të nevojshme në llogarinë përfundimtare të shumës totale dhe mbas marrjes së proces verbalit të kolaudimit, autoriteti kontraktor do të lëshojë çertifikatën e marrjes në dorëzim të punimeve dhe do të çlirojë garancinë e sigurimit të kontratës.

Neni 29

Ndërprerja për Mosplotësim

1. Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
 - a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
 - b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.
2. Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.
3. Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim të kushteve të saj

Neni 30

Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

1. Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paafte të paguajë.
2. Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

Neni 31


Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

1. Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.
2. Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.
3. Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuar dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjeshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohej të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

Neni 32

PRISHJA E KONTRATËS

10
REPUBLICA E SHQIPERISE
PRISHJE
10



Autoriteti kontraktor ose sipermarrësi mund të pezullojë kontratën në raste kur bëhen shkelje themelore të saj.

Shkeljet themelore të kontratës përfshijnë por nuk kufizojnë në sa vijon

- a. Operatori ekonomik nuk fillon punën menjehere pas dates te dhenies te lejes se ndertimit dhe te hartimit te proces-verbalit te dorezimit te sheshit te ndertimit .
- b. Operatori ekonomik ndalon punimet per 15 dite kur nuk eshte parashikuar nderprerja e tyre ne programin e punimeve te miratuara dhe kur drejtuesi i projektit nuk ka autorizuar nderprerjen e tyre.
- c. Drejtuesi i projektit udhëzon pezullimin e punimeve dhe ky udhezim nuk terhiqet prej tij brenda 15 diteve ose nuk arrihet marreveshja per pagimin e kosos te shtyrjes nga operatori ekonomik.
- d. Operatori ekonomik falimenton ose fillon likuidimin për arsye të tjera përveç rindertimit ose bashkimit të shoqërisë.
- e. Operatori ekonomik vonon kryerjen e punimeve dhe nuk realizon korigjimet e propozuara nga drejtuesi i projektit.
- f. Drejtuesi i projektit dergon njoftimin se mos korigjimi i nje difekti te posaçem paraqet shkelje themelore te kontrates dhe operatori ekonomik nuk e korigjon ate brenda 30 diteve te percaktuara nga drejtuesi i projektit.
- g. Kur operatori ekonomik njofton autoritetin kontraktor per shkelje te kontrates per ndonje shkak perveç ndryshimit te kosos si rrjedhim i ndryshimit te legjislacionit eshte e drejta e autoritetit kontraktor te vendose nese shkelja eshte themelore ose jo. Autoriteti kontraktor kur ka arsye objektive mund te prishe kontraten duke I dhene operatori ekonomik nje njoftim me shkrim brenda nje afati prej 30 ditesh.

Neni 33

PASOJAT PAS PRISHJES SE KONTRATES


- a. Në rast se kontrata prishet për shkelje themelore nga ana e operatorit ekonomik, drejtuesi i projektit do të lëshojë një certifikatë pagese për vlerën e punës së kryer duke zbritur pagesat e mepareshme ,vleren e plote te paradhenies dhe vleren e garancise se cilesise se punimeve te realizuara.
- b. Në rast se kontrata prishet nga autoriteti kontraktor për arsye te shkeljes themelore te kontrates ose per arsye te tjera objektive , drejtuesi i projektit do të lëshojë një certifikatë për vlerën e punës së kryer ,per vleren e prodhimeve te gatshme me te cilat eshte furnizuar objekti,per shpenzimet e operatorit ekonomik per mbrojtjen e sigurimin e punimeve duke zbritur pagesat e marra deri ne ditën e leshimit te saj sipas paragrafit te mesiperm.
- c. Në rastet e prishjes së kontratës për shkakun e operatorit ekonomik, Bashkia ka të drejtën të sekestrojë garancinë e kontratës në masën e caktuar në kontratë.
- d. Në rastet e prishjes së kontratës për shkakun e operatorit ekonomik, Bashkia ka të drejtën gjithashtu t'i kërkojë dëmshpërbilim operatorit ekonomik në masën e dëmit të shkaktuar.

Neni 34

PASURIA

*Të gjitha punimet e kryera do të konsiderohen pronë e autoritetit kontraktor në rast prishje të kontratës.

NIRA SY...
HIPOT...
SHKURT... - ALBANIJA



GARANCIA E TE METAVE TE SENDIT

Në kuptim të nenit 864 të Kodit Civil afati i garancisë për të metat apo deformimet e vepres është 24 muaj pas kolaudimit perfundimtar të objektit. Ky afat nuk përfshin rastet e parashikuara në nenin 866 të Kodit Civil.

Neni 36

MONITORIMI I KONTRATËS

Supervizori (mbikeqyrsi i punimeve) do jete Ingj Natasha Myrtaj e pajisur me licencen

Autoriteti kontraktor në kuptimin e nenit 62, të ligjit 9643 dt.20-11-2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar dhe Kreut III, pika 2 të VKM 1 dt. 10-01-2007 "Mbi rregullat e prokurimit publik" i ndryshuar në cdo rast mund të ushtrojë kontrolle për zbatimin e kontratës, ose lëvrimet, dhe në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë.

Gjatë kryerjes së kontrolleve Autoriteti Kontraktor mban proces-verbal me shkrim. Në përfundim të kontratës, Autoriteti Kontraktor përgatit një raport përmbledhës për korrektësinë dhe cilësinë e zbatimit të kontratës. Një kopje e këtij raporti i jepet edhe kontraktorit me kërkesë të tij.

Neni: 37

Raportimi i Grafikut të Zbatimit


1. Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .
2. Në intervale të skeduar rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

Neni 38

Testimet dhe Inspektimet

1. Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës.
2. Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose përgatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto teste dhe inspektime.
3. Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë teste ose inspektime shtesë të parashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testeve. Gjithashtu, nëse këto

NIKA SH.K.K.
NIPY JEDINEN
SHKODER



teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

4. Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo Punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.
5. As egzekutimi i testeve as inspektimi i Punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

Neni 39

Garancitë


1. Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me Punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.
2. Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

Neni 40

NENKONTRAKTIMI

1. Per pjesen e punimeve qe kontraktuesi mund te kete paraqitur ne oferten fituese se do t'i realizoje me nenkontraktues, përpara lidhjes së kesaj kontrate, duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një kopje të noterizuar të marrëveshjes së nënkontraktimit dhe dëshminë e kualifikimeve dhe të kërkesave teknike të nënkontraktorit, në mënyrë të tillë që autoriteti kontraktor të mund të miratojë nënkontraktimin.
2. Gjatë ekzekutimit të kontratës autoriteti kontraktor duhet të kontrollojë se punët e shërbimet kryhen nga nënkontraktorë të autorizuar.
3. Kontraktuesi nuk duhet të nënkontrakttojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Institucionit publik. Kontraktuesi duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nën-kontraktohet dhe identitetin e nën-Kontraktuesit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë Kontraktuesin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet në se e aprovon apo jo atë.
4. Dispozitat e këtij neni nuk prekin përgjegjësitë kryesore të operatorit ekonomik ndaj autoritetit kontraktor, për të cilin nënkontraktorët mbeten palë e tretë, kundrejt marrëdhënies kontraktuale ndërmjet operatorit ekonomik dhe nënkontraktorëve të tij dhe duke e lënë operatorin ekonomik kryesor përgjegjës për zbatimin e të gjithë kontratës, pavarësisht se një pjesë e saj zbatohet nga nënkontraktorët.

NIKAJ G.P.
NIPK 10070010
SHRODESHI
TIRANA



Neni 41
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

*Autoriteti kontraktor dhe operatori ekonomik do të zgjidhin me mirëkuptim çdo mosmarrëveshje që do të lind gjatë realizimit të kësaj kontrate. Në rast se nuk bien dakort atëherë do t'i drejtohen Gjykatës Rrethit Shkoder.

Neni 42
ADMINISTRIMI I KONTRATES


*Kontrata hartohet ,administrohet dhe interpretohet sipas ligjeve te R.Sh. Kjo kontratë bazohet në tenderin e zhvilluar me dt.01.07.2011, Të dhënat për operatorin ekonomik, afatin, vlefshëm, burimin e financimit dhe periudhën e garancisë janë siguruar nga Njësia e prokurimeve, e cila ka ndjekur proceduren e zhvillimit të tenderit.

Neni 43
VLEFSHMËRIA E KONTRATËS

-Kjo kontratë do të quhet e vlefshme duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palet.
-Kjo kontrate u hartua ne gjashte kopje, nga dy kopje per palët dhe një kopje për drejtuesin e projektit.
Pjese integrale e kesaj kontrate jane edhe oferta fituese,preventivi i punimeve, grafiku i punimeve,deklarata per emrimin e drejtuesit teknik te punimeve,deklarata per makinerite e angazhuara per realizimin e punimeve.

PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR


Bashkia Vau-Dejes
Kryetari i Bashkisë
Gjon MARKU



PER OPERATORIN EKONOMIK
Operatoti "NIKA"SH.P.K.
Administratori
Shpresa NIKAJ



NIKA SH.P.K.
HIPT 13/01/2011
SHKODER - KOSOVA



KUSHTET E VEÇANTA TE KONTRATES

1/16

(a) Punët – PROCEDURA: KERKESE PER PROPOZIM

Kushtet e veçanta të mëposhtme të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se do të ndodhë ndonjë konflikt, dispozitat e mëposhtme do të mbizotërojnë ato të Kushteve të Përgjithshme.

Neni 1: Përkufizime

- 1.1 Autoriteti Kontraktor është : BASHKIA VAU-DEJES
- 1.2 Kontraktori është “Operatori Ekonomik ”NIKA” sh.p.k.

Neni 2: Sigurimi i Kontrates

- 2.1 Sigurimi i kontrates në shumën prej (10% të vlerës së ofertës) duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar egzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.
- 2.2 Sigurimi i kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm:

-Sigurimi i kontrates në shumën sipas pikes se mesiperme 2.1 do të kthehet, kontraktorit pas aktit perfundimtar te kolaudimit te objektetit.

-Polica e sigurimit.

Neni 3: Drejtuesi i Projektit

- 3.1 Drejtuesi i Projektit do të jetë: Ing.Natasha MYRTAJ

Neni 4: Kantieri

- 4.1 Kantieri i Punëve do të jetë: “Brenda sheshit te ndertimit te percaktuar ne projekt”


Neni 5 Data e Fillimit

- 5.1 Kontraktorit do t'i jepet leja për të hyrë në kantier në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate.

6: Siguracioni

- 6.1 Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën e plote referuar preventivit :
 - a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve
 - b. Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve
 - c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe PajisjeveGjithashtu:

NIKA SH.P.K.
RRETHI I DEJES
SHALLKË, ALBANIJA



Neni 7: Inspektimet dhe Testimet

- 7.1 Inspektimet dhe testimet para vërtetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë të gjithë zërat e punëve për të cilat parashikohen në specifikimet teknike dhe që autoriteti kontraktor i sheh si të nevojshme për t'u testuar.

Neni 8: Lloji i Kontratës

- 8.1 Kjo kontratë do të çmohet si një

Kontratë me Çmim Njesie të bazuar në çmimet e njesise të shprehura në Preventivin fitues ne Njesi (per punime ne matje me cmime te pandryshueshme).

Kontratë me Shumë Totale

Neni 9: Grafiku i Pagesës

- 9.1 Pagesat per çdo situacion punimesh do të kryhen nga autoriteti kontraktor brenda 30 ditëve nga dita e firmosjes së situacionit nga drejtuesi i projektit

- 9.2 Monedha e pagesës do të jetë leke. Nëse nuk është specifikuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

Neni 10. Pagesa Paraprake

- 10.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë Nuk Ka. Nëse nuk është specifikuar, kontraktori nuk do të marrë pagesë paraprake.

PËR AUTORITETIN KONTRAKTOR

Bashkia Vau-Dejes
Kryetari i Bashkisë
Gjon MARKU

PER OPERATORIN EKONOMIK

Operatori "NIKA" sh.p.k.
Administrator
Shpresa NIKA

NIKA
WIPET
SHKURDET
ALBANIA